



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202000848/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave për përfundimin sa më parë të procedimit administrativ për rishqyrtimin e vetëdeklarimit të kryer prej z.S.Z.U., dhe njëherazi, shqyrtimin e deklaratës "Për përfshirjen në procedurën e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesë në ndërtim me leje", nr.2299, datë 12.12.2014, të kryer prej shtetases M.M..*

Drejtuar : **Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana-Veri**

TIRANË

I nderuar z.Drejtor

Sikurse jeni në dijeni, Institucioni i Avokatit të Popullit ka në proces shqyrtimi ankesën e shtetases M.M., e cila ankohet ndaj organit që ju drejtoni për mospërfundimin e procedurës administrative të nisur mbi bazë të deklaratës "Për përfshirjen në procedurën e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje", nr.2299, datë 12.12.2014, për legalizimin e ndërtimit të ndodhur në Lagjen "Vangjel Noti", Rruga "Buna", Njësia Administrative nr.12, Tiranë.

Për këtë ndërtim, konstatohet, se, ish-ALUIZNI Tirana 1, sot Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana-Veri (DVASHK-ja), ka nxjerrë aktin, Lejen e Legalizimit nr.79104, datë 17.02.2016, në emër të z.S.Z.U., ish-kunati ankueses, i cila, me vendim gjyqësor të formës së prerë nr.630, datë 23.02.2018, të dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, është konstatuar akt administrativ i pavlefshëm, për shkaqet e përmendura në këtë vendim, si dhe detyrimi i ZVRPP Tiranë, (sot-DVASHK-ja Tirana-Veri), të fshijë regjistrimin e titullit të pronësisë, Lejes së Legalizimit nr.79104, datë 17.02.2006.

Referuar shkresës nr.6699/1 Prot, datë 02.10.2019, të DVASHK-së Tirana-Veri, drejtuar Avokatit të Popullit, rezulton, se, vendimi gjyqësor i formës së prerë nr.630, datë 23.02.2018, (marrë formë të prerë më datë 10.04.2018), është ekzekutuar, pra është kryer fshirja e regjistrimit nga regjistri i pasurive të paluajtshme të Lejes së Legalizimit nr.79104, datë 17.02.2016.

Në situatën juridike të lartpërmendur, Drejtoria që ju drejtoni, duhet të kishte përfunduar procedurën e rishqyrtimit të vetëdeklarimit të kryer prej z.S.Z.U., si dhe shqyrtimin njëherazi të deklaratës nr.2299, datë 12.12.2014, të kryer prej zj.M.M., për legalizimin ose jo, të ndërtimit informal, të ndodhur mbi pasurinë "truall" të regjistruar

në regjistrin e pasurive të paluajtshme me nr.2.120, vol 29, faqe 170, ZK 8310. Në pjesën arsyetuese të vendimit gjyqësor nr.630, datë 23.02.2018, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, shprehet rreth shkaqeve të pavlefshmërisë së Lejes së Legalizimit nr.79104, datë 17.02.2016, në emër të S.Z.U., dhe konkretisht¹:

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me Vendimin nr.630, datë 23.02.2018, ka vendosur midis të tjerave, për:

“Konstatimin e pavlefshmërisë të aktit administrativ, pikërisht Lejes së legalizimit nr.79104, datë 17.02.2016, nxjerrë në emër të shtetasit S.Z.U..

Detyrimin e palës së paditur të fshijë regjistrimin e bërë në ZVRPP, Tiranë, të aktit administrativ, Leje e legalizimit nr.79104, datë 17.02.2016”.

Kërkesa për fshirjen e regjistrimit të Lejes së legalizimit nr.79104, datë 17.02.2016, është kryer prej ankueses më datë 02.07.2018 (aplikimi nr.64134). Referuar afateve të përcaktuara në listën e shërbimeve, kuptohet, se, ekzekutimi i vendimit gjyqësor ka përfunduar qysh në muajin Korrik 2018.

Në kushtet e përmbushjes së detyrimit të vendosur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, DVASHK-ja Tirana-Veri, duhet të kish përfunduar procedurën administrative të rishqyrtimit të vetëdeklarimit të z.S.Z.U. dhe njëherazi shqyrtimin e deklaratës *“Për përfshirjen në procedurën e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje”*, nr.2299, datë 12.12.2014, të kryer prej M.M. në vitin 2014, për legalizimin e ndërtimit të ndodhur në Lagjen “Vangjel Noti”, Rruga “Buna”, Njësia Administrative nr.12, Tiranë.

Në Tuajën nr.6699 Prot, datë 02.10.2019, ju z.Drejtor, shpreheni, midis të tjerave, se:

“Përsa i përket procedurës për përfundimin e procesit të legalizimit të objektit informal do të vijohet, konform ligjit nr.9482/2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve paleje”, të ndryshuar, dhe VKM-së nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet pa leje”, i ndryshuar”.

Respektimi i detyrimeve ligjore, si dhe përfundimi i këtij procedimi administrativ në aftin ligjor të parashikuar në nenin 91 të Kodit të Procedurës Administrative nuk ka ndodhur. Ky qëndrim i mbajtur prej Drejtorisë Vendore të DVASHK-së Tirana-Veri, nuk vjen në përputhje me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse parashikuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë apo nenin 6/1 të Konvetës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Mosrespektimi i detyrimit ligjor prej Drejtorisë Vendore të DVASHK-së Tirana-Veri, për përfundimin e shqyrtimit të vetëdeklarimit të S.Z.U. apo deklaratës *“Për përfshirjen në procedurën e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje”*, nr.2299, datë 12.12.2014, të kryer nga ankuesja zj.M.M., prej datës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.630, datë 23.02.2018, ka shkelur

¹ *“... rezultoi e provuar, se, paditësja, ka aplikuar konform ligjit për legalizimin e objektit informal, banesë, dhe se në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin ...”, kjo deklaratë nuk është marrë në konsideratë nga i padituri.*

Ky fak provohet edhe nga vetë i padituri, ALUIZNI, Tirana-Veri, në shkresën e tij nr.2990/1 Prot, datë 19.06.2017, ku përcaktohet se është disponuar me leje legalizimi nr.79104, datë 17.02.2016, në emër të Sokol Zef Ulndreaj, pasi nuk kishte dijeni, se, ky objekt ishte deklaruar edhe nga paditësja Mare Mali dhe se për deklarimin e saj nuk është kryer azhurnim”.

parimin e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë, efikasitetit dhe deburokratizimit, transparencës, drejtësisë dhe paanësisë, në veprimtarinë e organeve publike.

DVASHK-së Tirana-Veri, administron gjithë dokumentacionin e nevojshëm e të mjaftueshëm për përfundimin e procedurës administrative të nisur mbi bazë të vetëdeklarimit apo deklaratës së subjekteve në fjalë. Për çështjen objekt prezantimi, sjellim në vëmendje, se, angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë po bëhen dhe më konkrete, sidomos në fushën e të drejtave të njeriut.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problem, e çmon me vend të dërgojë këtë rekomandim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për ndërprerjen e situatës së cënimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Në gjykimin tonë, lidhur me ecurinë e zhvillimit të proceseve të vendimarrjes në rastet e trajtimit të vetëdeklarimeve të paraqitura për legalizimin e ndërtimeve informale, duhet që DVASHK-ja Tirana - Veri, të shohë dhe shqyrtojë me përparësi ato raste të cilat lidhen me persona vetëdeklarues që i përkasin kategorive të shteresave vunerabël, komuniteteve në risk apo dhe personave me aftësi të kufizuara, sikurse na paraqitete rasti i ankueses. Këtij qëndrimi i bashkangjitet dhe fakti kohës së hershme në të cilën ajo ka bërë vetëdeklarimin e ndërtimit informal, fakt që në dijenin tonë e përcakton trajtimin e këtij vetëdeklarimi, si një rast me përparësi trajtimi nga ana juaj.

Për arsyet e përmendura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet, se:

“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”,

si dhe parashikimit të kryer në nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”,* të ndryshuar, se:

“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrative që ka shkaktuar shkeljen”.

REKOMANDOJMË

“Marrja e masave për përfundimin sa më parë të procedimit administrativ për rishqyrtimin e vetëdeklarimit të kryer z.S.Z.U., dhe njëherazi, shqyrtimin e deklaratës “Për përfshirjen në procedurën e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesë në ndërtim me leje”, nr.2299, datë 12.12.2014, të kryer prej shtetases M.M.”.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform parashikimit të kryer në nenin 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”,* të ndryshuar, kthimi përgjigjes të kryhet nga ana juaj mundësisht brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Prof.Asoc.Dr.Erjona BANA(CANAJ)